BASHKIA SHKODER

PLANI I VEPRIMIT

PER PERMIRESIMIN E SHERBIMIT TE KULLIMIT

MENAXHIMI I PERFORMANCES NEPERMJET PERFSHIRJES SE QYTETAREVE NE PROCESIN E KONSULTIMIT, ADVOKIMIT DHE MONITORIMIT

ASISTUAR NGA **LEVIZ ALBANIA** NEPERMJET **I.S.D.C**

SHKODER 2017

PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT TË KULLIMIT PËRMES PËRFSHIRJES QYTETARE NË PROCESET E KONSULTIMIT, ADVOKIMIT DHE MONITORIMIT

BASHKIA SHKODËR
Njësitë Administrative
Velipojë, Dajç, Ana e Malit, Guri i Zi, Bërdicë

"...Decentralizimi, apo qeverisja e decentralizuar, i referohet ristrukturimit ose riorganizimit të autoritetit në mënyrë që të ketë një sistem të bashkë-përgjegjësisë ndërmjet institucioneve të qeverisjes në nivel qendror, rajonal dhe vendor në përputhje me parimin e subsidiaritetit, duke rritur cilësinë e përgjithshme dhe efektivitetin e sistemit të qeverisjes, duke rritur autoritetin dhe kapacitetet e nivelit nën-kombëtar. Decentralizimi gjithashtu mund të pritet të kontribuojë në elementet kyç të qeverisjes së mirë, të tilla si rritjen e mundësive të njerëzve për pjesëmarrje në vendimet ekonomike, sociale dhe politike, duke ndihmuar në zhvillimin e kapaciteteve të njerëzve dhe rritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë, transparencën dhe llogaridhënien."[1] (PNUD,1997:4)

[1] PNUD, Decentralized Governance Programme: Strengthening Capacity for People -Centered Development, Management Development and Governance Division, Bureau for Development Policy, September 1997, p. 4

NJË BASHKI E SUKSESSHME

- Gjeneron përfitime te prekshme dhe te përhershme per komunitetin e saj ne formën e shërbimeve vendore te përmirësuara dhe te vëmendjes miqësore ndaj qytetare klientë
- Ka rrënjosur angazhimin, pergjegjshmerine dhe shërbimin qytetar ndaj klientit ne proceset e saj te vendim marrjes dhe ne menaxhimin e saj te përditshëm
- Prodhon dhe shton sensin ne komunitet se ajo është reaguese ndaj dhe e hapur ndaj nevojave te tyre.
- Krijon një lidhje te forte besimi ndërmjet autoriteteve vendore, qytetare, bizneseve dhe shoqërisë civile qe ndihmon ne uljen e korrupsionit ne nivel vendor
- Ofron një kuadër per shoqërinë civile qe te marre një rol te zgjeruar ne procesin politik.

PREZANTIM

Projekti **LevizAlbania** mbeshtet nisma te shoqeris Civile per te nxitur pjesmarrjen e qytetareve ne vendimarrje ne menyre qe te rritet llogardhenia, bashkepunimi dhe pjesmarrja e tyre ne qeverisjen vendore. Po keshtu, ky project nxit bashkepunimin ne nivel vendor te aktorve relevante me qellim rritjen e efikasitetit dhe eficences se egzekutimit te fondeve publike.

Ne kete kuader LevizAlbania mbeshteti aplikimin e **ISDC** (*Qendres per Zhvillim te Qendrushem dhe te Integruar*) me projekt propozimin e saj per te permiresuar sherbimin e kullimit ne bashkine Shkoder.

Projekti u mbeshtetet ne nje metodologji te caktuar ku perfshihen, Administrata, Keshilltare, Qytetaret, experte, media dhe shoqata te ndryshme e grupe interesi. Ekspertiza eshte mbuluar nga eksperti i qeverisjes vendore **Z.Fatlum NURJA**.

Per te ardhur deri ne kete document analitik rruga rruga ka qene shume e gjate dhe e veshtire.

Si fillim duam te themi qe sherbimi u zgjodh si pilot nga kryetarja e bashkise **Znj.Voltana ADEMI** e cila kerkonte qe metoda e manaxhimit te performances, metja e rezutateve nepermjet indikatorve si dhe buxhetimi me pjesmarrjen e publikut te behej me kete sherbim ne 5 njesite administrative te bashkis Shkoder, ate te Anes se Malit, Berdices, Dajci, Gurit te Zi dhe Velipojes.

Per kete jane kryer:

- 10 Worshope e seminare.
- 6 Takime ne njesi administrative me stafin e qytetaret per te identifikuar aktoret e ardheshem.
- 5 Takime me focus grupet e qytetaret.
- 2 Dite seminar me Vezhguesit e Kualifikuar
- 1 Emision Televiziv, etj.

Eshte ndertuar nje spot sensibilizues ne TV Lokal, eshte hape nje faqe e dedikuar ne fb, jane prodhuar postera e flat palosje me qellim sensibilizimin e aktoreve dhe ndergjegjesimin e qytetareve per permiresimin e ketij sherbimi.

Ne keto takime kane marre pjese mbi 200 persona te ndryshem te cilet kane dhene mendimet e tyre ne hartimin e dokumentit, ku per te bere efektiv eshte filluar qe me krijimin e formulareve te inventarit fizik, problemeatikes aktuale dhe gjendjes se rretit te kullimit e veprave perkatese, vlersimi me vezhgues te kualifikuar dhe anketimi i qytetarve.

Ky document eshte nje shebull kuoptimplote se sa pune duhet ne nje nivel te tille administrativ sic eshte Bashkia per te programuar dhe buxhetuar ne raport me kerkesat e ligjit per Vete-Qeverisjen Vendore.

Por, pavaresisht veshtiresive, mund te themi qe kjo eshte rruga e vetme ku qytetaret perfshihen ne vendimarrje, ku ato vendosin vete se cfar kane nevoje, ku kostot dhe produktet kontrollohen jo vetem nga menaxheret e larte por dhe qytetaret e media, ku keshilltaret jane te perfshire qe ne fillim ne politikberje, ku media ndjek hap pas hapi procesin dhe raporton tek qytetaret.

Puna nuk mbaron ketu.

Ketij dokumenti i bashkengjitet ne respekt te ligjit No.139/2015 Per “Vete-Qeverisjen Vendore” edhe rregullorja e sherbimit e cila do beje te qarte rolet dhe pergjegjesit e secilit institucion apo departament ne ofrimin e ketij sherbimi. Kjo rregullore shpresojme te sjelle risi dhe te jete hap i pare edhe per te tjera rregullore per sherbime te ndryshme ne bashki.

Me aprovimin e ketij dokumenti puna do vazhdoje me mbajtjen e nje Konference vendore ku ne pergjithesi te flitet per kete sherbim dhe ne vecanti te njifen pjesmarresit me punen e bere.

Puna ne muajt me tej do vazhdoje me monitorimin e Planit te Punes se miratuar dhe raportimi i tij ne media dhe tek qytetaret.

Ne fund, por jo nga rendesia, Grupi i Punes ka deshire te Falenderoje te gjithe pjesmarresit ne project per punen, perkushtimin dhe seriozitietin e treguar. Ky ishte nje document i pare por

shpresojme qe nen kete shembull edhe sherbime te tjera te behen dhe te buxhetohen ne kete forme duke plotesuar ne menure gjithe perfshirese kerkesat ligjore per ezekutimin e funksioneve dhe ofrimin e sherbimeve.

Faleminderit
Grupi Punes

SHPJEGIM

Cfarë eshte nje PVPSH (Plan Veprimi per Permiresim Sherbimi)

Një proces dhe kuadër i bazuar ne parimet e menaxhimit te performances qe ndihmon një komunitet per te përmirësuar një shërbim apo per te trajtuar një çështje te veçante duke e perfshire ate ne pjesmarrje aktive ne vendosje prioritetesh dhe ne buxhetim.

1. GRUPI I PUNËS

1.1. Antaret e Grupit te Punes per Plan Veprimi per Permiresimin e Sherbimit te mirembajtjes se kanaleve kulluese

Në grupin kryesor të punës janë përfshirë drejtuesite drejtorive kryesore që kanë funksion të punës së tyre administrimin dhe menaxhimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit të kanaleve kulluese në Bashkinë Shkodër. Në këtë grup marrin pjesë edhe këshilltarë, si pjesë e rëndësishme e vendimarrjes dhe përfaqësues i medias.

GRUPI KRYESOR

1	Arben	Gjuraj	Zv. Kryetar	arbengjuraj@gmail.com	698914005
2	Alban	Sekja	Drejtor (DBZHRTA)	albansekja@yahoo.com	672082858
3	Arben	Lushaj	Drejtor (DSHBP)	benlushaj@hotmail.com	695438006
4	Teuta	Haxhi	Drejtor e planifikimit buxheto	teutahaxhi@yahoo.com	692251796
5	Blerta	Rrjolli	Drejtor Finance	brrjolli@yahoo.com	674903435
6	Isuf	Meta	Keshilltar (Komis Financave)	isufmeta@yahoo.com	694033496
7	Marin	Pema	Keshilltar (kom Bujqesise)	marin_pema@hotmail.com	674453611
8	Manjola	Fushxhija	Juriste		693501377
9	Senad	Nikshiqi	Gazetar	senadnikshiqi@yahoo.com	674395639

Në secilin nga grupet ndihmëse të punës në çdo njësi administrative kjanë përfshirë administratorët e njësive, ekspertë. Inspektorë të sektorit, përfaqësues të grupeve të fermerëve apo individë dhe kryetarë të fshatrave, përfaqësues të komunitetit.

GRUPET NDIHMESE

-NJESIA ADMINISTRATIVE GURI i ZI

1	Pjerin	Marku	Administrator	pjerinmarku@yahoo.com	694265387
2	Qazim	Zaja	inspektor	qazim_zaja@yahoo.com	684071608
3	Alfred	Haxhari	Ekspert	fred_haxhari@yahoo.com	682033233
4	Perparim	Bajraktari	Specialist(DSHBP)	pbajraktari82@gmail.com	672563191
5	Klisman	Preka	Student	preka_klisman@yahoo.com	674312952
6	Is'hak	Bajrami	Kryetar sh.b.b.		672935771
7	Kujtim	Toka	Fermer.Perfitues		692410287

-NJESIA ADMINISTRATIVE VELIPOJE

1	Altin	Kaci	Administrator	altinkaci@yahoo.com	673795551
2	Berhan	Zeka	inspektor	berhanzekja@yahoo.com	673163240
3	Ardit	Cylybyli	Pergjegjes(DSHBP)	arditcylybli@icloud.com	695276677
4	Ded	Jaku	kryeplak		693472788
5	Tome	Game	Ekspert	tomegame@hotmail.it	684629974
6	Ferd	Nika	kryeplak		673679883
7	Lon	Ujka	fermer perfitues		672239503

-NJESIA ADMINISTRATIVE ANA MALIT

1	Arben	Ceni	Administrator	arben.ceni@yahoo.com	693200571
2	Enton	Deda	inspektor	entondeda@protonmail.com	693391377
3	Marin	Pema	Keshilltar Bashkiak	marin_pema@hotmail.com	674453611
4	Valentin	Gocaj	Ekspert	vgocaj@yahoo.com	692236599
5	Servet	Kraja	kryeplak		

-NJESIA ADMINISTRATIVE DAJC

1	Gjovalin	Darragjati	Administrator	gjovalindarragjati@gmail.com	692533895
2	Ernest	Lukaj	inspektor	ernestluka@gmail.com	692449927
3	Osman	Osmani	kryeplak		683855752
4	Agim	Bushaj	Specialist(DSHBP)	agimbushaj1@gmail.com	674857895
5	Adi	Garuci	inspektor	adigaruci@hotmail.com	692168028

-NJESIA ADMINISTRATIVE BERDICE

1	Aleksander	Pashuku	Administrator	pashukualeksander@hotmail.com	673021690
2	Xhavit	Pellumbi	inspektor	xhavitpellumbi@yahoo.com	665905682
3	Ardian	Todhri	inspektor	ardian_todhri@yahoo.it	694098070
4	Isuf	Meta	Keshilltar Bashkiak	isufmeta@yahoo.com	694033496
5	Fatmir	Mehja	kryeplak		682466902

2. ANALIZA E SITUATES AKTUALE

2.1. Të dhëna të përgjithshme

- Populsia e Shkodrës

Ndarja e re territoriale përcaktoi si qendër të bashkisë së re qytetin e Shkodrës, themeluar në shekullin e katërt para Krishtit nga fisi ilir i Labeatëve. i vendosur në një fushë të gjerë në veri-perëndim të Shqipërisë, qyteti i Shkodrës është sot qendra jo vetëm politike dhe administrative por edhe ekonomike dhe kulturore e Shqipërisë së veriut. Me universitetin, bibliotekat, arkivat, kishat, xhamitë dhe muzetë ajo ofron një pamje të larmishme të Shqipërisë së sotme, që shkon drejt zhvillimit e në të njëjtën kohë qëndron e lidhur me traditat e vendit.

Tabela 1. Ndarja territoriale e Bashkisë Shkodër

Nj.A	Fshatrat	Kufizimi Veri	Kufizimi Jug	Kufizimi Lindje	Kufizimi Perëndim
Shkodër	Qyteti Shkodër	Rrethina	Bërdicë, Guri i Zi	Rrethina, Guri i Zi	Liqeni i Shkodrës
Ana e Malit	Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e Sipërme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar	Shkodër	Lumi Buna Dajç	Rrethina	Mali i Zi
Bërdicë	Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Sipërme, Trush, Beltojë, Mali Hebaj	Shkodër	Bushat	Guri i Zi Lumi Drin	Dajç
Dajç	Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërm, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq	Lumi Buna Ana e Malit Mali i Zi	Velipojë	Bërdicë Bushat	Lumi Buna
Guri i Zi	Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor	Postribë Shllak	Bushat Vau i Dejës	Vau i Dejës	Bërdicë Shkodër
Velipojë	Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj	Dajç	Deti Adriatik	Lezhe	Lumi Buna
Postribë	Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz	Pult Malësi e Madhe	Guri i Zi	Shllak	Rrethina
Pult	Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull	Shalë Malësi e Madhe	Postribë Shllak	Shosh Shalë	Malësi e Madhe
Rrethinat	Dobraç, Grudë e Re, ShtojiRi, Guci e Re, Shtoj i vjetër, Zues, Golem, Hoti i Ri, Bleran, Bardhaj	Gruemirë	ShkodërGuri i Zi	Postribë	Liqeni Shkodër
Shalë	Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Ndërlysaj, Gimaj, Nënmavriq, Lotaj	Kosove	Shosh Tropojë	Tropojë	Malësi e Madhe Pult
Shosh	Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsumaj, Brashtë	Shalë	Temal Shllak	Pult	Temal Tropoje Vau i Dejës

Burimi: Bashkia Shkoder



Me një ekosistem të larmishëm (Liqeni i Shkodrës, lumi Buna, Drin, Kir), shumë pranë detit Adriatik dhe pika më e afërt e transitit drejt veriut të gadishullit të Ballkanit dhe tregun e Bashkimit Evropian (me rrugë tokësore e hekurudhore), bashkia Shkodër manifeston të gjitha parakushtet e një zone të rëndësishme tregtare dhe transiti, si dhe një qendër e rëndësishme ekonomike dhe industriale e Shqipërisë.

2.2. Karakteristikat gjeografike

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në një territor prej 873 km², i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.

Bashkia e Shkodrës përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë).

Qyteti i Shkodrës ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë. Në veriperëndim të tij ndodhet Liqeni i Shkodrës, i cili me nje siperfaqe prej 368 km² është liqeni më i madh në Ballkan. Nga ky liqen buron Lumi Buna (44 km), i cili derdhet në detin Adriatik dhe rrjedha e poshtme e te cilit ndan kufirin me Malin e Zi.Lumi Buna bashkohet me lumin Drin rreth 2 km në jugperëndim të qytetit. Nga ana lindore qyteti kufizohet me Lumin Kir, i cili buron nga Malësitë e Veriut dhe është 43 km i gjatë. Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore. Pjesa kryesore fushore e qytetit sot ka një shtrirje prej 1,150 ha, ndërsa pjesa kodrinore ka një shtrirje prej 350 ha.

Shkodra nga ana lindore dhe jugore rrethohet nga një varg kodrash deri në 110 m lartësi, kodrat e Rrencit në lindje dhe të Tepes në jug. Në jugperëndim gjendet kodra shkëmbore e kalasë së Rozafës me lartësi 130 m dhe sipërfaqe 3.6 ha. Rreth 30 km në juglindje ndodhet bregdeti Adriatik me Plazhin e Velipojës.

Nga veriu dhe veriperëndimi shtrihet Fusha e Mbishkodrës përtej të cilës fillojnë Alpet e Shqipërisë, përkatësisht, Jezerca (2.694 m), Radohima (2.570 m).

Në pjesën jugperëndimore të qytetit të Shkodrës, në një distancë rrugore prej 22 km larg qendrës së saj ndodhet **njësia administrative Dajç**. Kjo njësi kufizohet në veri dhe veriperëndim me Lumin Buna dhe përtej saj me **njësinë administrative Ana e Malit**, ndërsa një pjesë e saj është në kufi me Malin e Zi. Në pjesën lindore dhe juglindore kufizohet me **njësinë administrative Bërdicë** dhe Bushat ndërsa në jug me njësinë **administrative Velipojë**.

Dajçi ka një shtrirje relativisht të madhe, prej 36.52 km² dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është tokë bujqësore me vlera të mira prodhuese. Zona e Dajçit disponon burime natyrore, ujore e mjedisore të konsiderueshme. Lumi Buna përbën një ndër elementet me vlera të mëdha natyrore që gjënden në Dajç. Aktivitetet kryesore ekonomike të viteve të fundit në këtë njësi janë bujqësia dhe blegtoria.

Berdica. Në pjesën jugore të qytetit ndodhet njësia administrative Berdicë me një sipërfaqe prej 31.02 km². Njësia administrative Bërdicë kufizohet në veri me qytetin Shkodër, në jug me njësinë administrative Bushat, në lindje me lumin Drin dhe në perëndim me njësinë administrative Dajç. Në jug-perëndim të qytetit të Shkodrës, në një distancë prej 6 km larg qendrës së saj ndodhet njësia administrative Ana e Malit me një sipërfaqe rreth 44 km².

Ajo kufizohet në veri dhe verilindje me qytetin e Shkodrës, në perëndim me Malin e Zi, në jug dhe juglindje me lumin Buna në një gjatësi prej 17 km si dhe në lindje me njësinë administrative Bërdicë.

Ana e Malit është kufitare me Malin e Zi dhe portë hyrëse nëpërmjet pikës doganore të përbashkët Mali i Zi - Shqipëri, pranë fshatit Muriqan. E gjithë zona disponon burime natyrore, ujore e mjedisore të konsiderueshme.

Në pjesën veriore të qytetit Shkodër ndodhet njësia administrative Rrethina me sipërfaqe 47,05 km². Territori i njësisë përshkohet nga rrugët nacionale Tiranë - Hani i Hotit dhe Shkodër - Muriqan.Kjo zonë bën pjesë pothuajse krejtësisht në Fushën e Mbishkodrës, në pjesën jugore të saj (fusha më e vogël e Shtojit) që do të thotë se ka një reliev kryesisht fushor, përjashtim bën fshati Zues, i cili shtrihet në pjesën më skajore të kodrës së Taraboshit, pranë lumit Buna. Aktivitetet kryesore në këtë zonë janë bujqësia dhe blektoria, të cilat përbëjnë edhe aktivitetet kryesore ekonomike të viteve të fundit.

Në juglindje të qytetit të Shkodrës, përgjatë rrugës rajonale Shkodër – Vau i Dejës ndodhet njësia administrative e **Gurit të Zi,** me një sipërfaqe prej rreth 81.7 km². Harta e pozicionit gjeografik të njësisë Guri i Zi është përqëndruar në fshatrat kodrinore dhe fushore në perëndim dhe më pak në zonat lindore, përgjatë brigjeve të liqenit artificial Vau i Dejës.Ajo kufizohet me njësitë administrative Postribë, Shllak, Bushat, Berdicë dhe Shkodër.

Njësia administrative përshkohet në pjesën juglindore të saj nga rruga automobilistike nacionale Shkodër – Pukë – Kukës – Kosovë. Zona dallohet për ruajtjen dhe zhvillimin e shumë kulturave bimore e drurëve frutore. Pasuri të shumta dhe cilësore të lëndëve inerte si rërë, zhavorr dhe lëndë e pare për prodhimin e tullave dhe tjegullave. Kjo zonë mbart vlera të veçanta arkeologjike dhe historike. Ekzistenca e pikave të veçanta me vlera turistike si Kalaja e Gajtanit, Kalaja e Ganjollës, Ishulli i Shurllahut (Sarda) etj.

Në jug të qytetit Shkodër në një distancë prej 25 km larg qëndrës së saj ndodhet njësia administrative **Velipojë** me një sipërfaqe rreth 72,4 km².Kjo njësi kufizohet në veriperëndim nga Mali i Zi përgjatë lumit Buna, në lindje nga Qarku i Lezhës, në veri nga Komuna e Dajçit dhe në jug nga deti Adriatik.

Pozita e favorshme gjeografike ku ndërthuren deti dhe lumi, laguna dhe rezervati natyror, fushat pjellore, kënetat dhe pyjet, kodrat dhe malet i japin kësaj njësie administrative një mundësi të madhe për zhvillimin e turizmit detar, lumor dhe malor, të peshkimit dhe të gjuetisë, të zhvillimit të kulturave të ndryshme bujqësore dhe të blegtorisë.
Përmendim këtu plazhin me gjatësi 14 km gjërësi rreth 300 m, Ligatinën e Velipojës (grykderdhjen e lumit Buna ku përfshihen 4 mocale të cekëta dhe këneta e Domjes), Rezervatin e Velipojës (700 ha, shtrihet në deltën e lumit Buna, rreth 8 km larg nga Velipoja, Ishulli i Franc Jozefit, Laguna e Vilunit, plazhi i Baks-Rrjollit.

2.3. Demografia

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë Shkodër është dyfishuar, aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej **204,954** banorë, përqëndrimi me i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 56% të popullsisë (**114,085** banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 23,923 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë Guri i Zi me 11,838 banorë, Postriba me 11,730 banorë, Bërdica me 9,655 banorë, Velipoja me 9,574 banorë dhe Dajçi me 8,998 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5,968 banorë, Pulti me 3,249 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5,934 banorë.

Tabela 1: Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative

Nr	Njësia Administrative	Nr. i banorëve	Nr.familje
1	Bashkia Shkodër	114,085	36,406
2	**Ana e Malit**	**5,968**	**1,629**
3	**Bërdicë**	**9,655**	**2,590**
4	**Dajç**	**8,998**	**2,236**
5	**Guri i Zi**	**11,838**	**3,301**
6	**Velipojë**	**9,574**	**2,583**
7	Pult	3,249	913
8	Rethina	23,923	6,936
9	Shalë	5,934	1,940
10	Shosh		
11	Postribë	11,730	3,007
Popullsia Totale/Nr.familjeve		**204,954**	**61,541**

Burimi:Bashkia Shkoder

Popullsia e qytetit të Shkodrës është homogjene me një popullatë e cila përgjithësisht ka patur levizje të brendshme demografike, pra nga zonat rurale drejt qytetit të Shkodërs, duke u përqëndruar në zonat e reja të banimit të krijuara pas viteve '90.

Rritjen më të ndjeshme të popullsisë Shkodra e ka arritur pas vitit 1960, rrjedhim i rritjes natyrale, 18/100 të popullsisë si dhe gjatë viteve '90 si pasojë e lëvizjes nga fshati në qytet. Dendësia mesatare e popullsisë arrin 135 banorë/km².



2.4. Profili ekonomik

Pas vitit '90 qeveria shqiptare ndërmori një sërë reformash dhe miratoi një sërë ligjesh që mbulonin pronësinë private, aktivitetin privat, investimet e huaja, mbrojtjen e konsumatorit, privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), dhe shumë elemente të tjerë të përfshirë në tregtinë moderne. Ekonomia e saj ndryshoi nga një ekonomi e centralizuar dhe e planifikuar në një ekonomi të tregut të lirë.Si rezultat i këtyre reformave, ndryshime të mëdha ndodhen në strukturën ekonomike të bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër vazhdon të jetë një nga kryeqendrat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, kjo për shkak të trashëgimisë, shpirtit sipërmarrës që karakterizon popullsinë si dhe vendndodhjes gjeografike. Qyteti i Shkodrës si qendër e zhvillimit të rajonit të veriut mban rolin e motorit të rritjes ekonomike edhe për njësitë e tjera administrative që e përbëjnë atë. Aktualisht sipërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme janë burimi kryesor i të ardhurave ekonomike dhe kanë një strukturë si më poshtë:

Tabela 2: Numri i bizneseve ne Njësite administrative në vitin 2016

Njësia Administrative	Nr. i bizneseve të mëdha	Nr. bizneseve të vogla
Shkodër	959	3,290
Velipojë	**150**	**337**
Ana Malit	**7**	**41**
Guri Zi	**16**	**113**
Dajç	**3**	**53**
Bërdicë	**33**	**114**
Rrethina	28	240
Postriba	14	88
Pult		5
Shosh		5
Shala		13
Totali	**1,210**	**4,299**

Vërehet se baza ekonomike përbëhet nga bizneset e vogla të cilët janë edhe katalizatorë të zhvillimit ekonomik pasi krijimi, zhvillimi dhe përmirësimi i këtyre bizneseve përbën një potencial të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Llojet kryesore të aktiviteteve që operojnë në Shkodër janë:

Tabela 3: Llojet aktivitetit të bizneseve

Lloji i aktivitetit
Bujqësia e Peshkimi
Industria ushqimore
Industria e tekstileve dhe veshjeve
Industria e lëkurave dhe këpucëve
Ndërtimi
Tregtia
Transporti **/** Komunikacioni
Aktivitete financiare dhe sigurimesh **etj.**

Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik janë kryesisht të orientuara në industrinë e lehte prodhuese, në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile si dhe tregti e biznese shërbimesh***. Si një zonë karakteristike prodhuese e produkteve bujqësore dhe blegtorale kemi prani të bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë.*** Gjithashtu edhe prania e bizneseve të artizanatit të cilët kanë një traditë të vjetër në qytetin e Shkodrës, vazhdon akoma sot duke luajtur rol të veçantë në zhvillimin ekonomik.

2.5. BUJQËSIA NË SHKODËR

Bashkia Shkodër ka një sipërfaqe të konsiderueshme të tokave bujqësore më një cilësi boniteti të lartë. Në përputhje me regjistrin e tokave bashkia Shkodër disponon 87 300 ha tokë gjithsej.

Me zbatimin e reformës se re administrative territoriale, pyjet dhe kullotat iu transferuan bashkisë së Shkodrës. Nga sipërfaqja e përgjithshme (perfshirë edhe zonat e mbrojtura), prej 52 520 ha, bashkisë Shkodrës i janë transferuar me VKM sipërfaqja prej 43 806 ha, nga të cilat: Pyje 30 992 ha, Kullota 5 377 ha, Sipërfaqe inproduktive 5 556 ha -tokë djerr 1 029 dhe bimësi pyjore 8 51.5 ha. Në këtë sipërfaqe gjenden të gjitha kategoritë e pyllit si pyll i rallë, pyll i dendur, shkurre të rralle, shkurre të dendur dhe livadhe e kullota dhe banim+natyrore. Ndërkohë përsa i përket prodhimit, mund të thuhet se në Shkodër ka një larmishmëri kulturash bujqësore të cilat prodhohen në territorin e bashkisë në periudha të ndryshme kohore.

Sipërfaqe dhe ndarje e tokës sipas njësive administrative.





Produktiviteti sipas njësive administrative





2.6. KLIMA

Klima e Shkodrës përcaktohet nga llojshmëria e relievit fushor, kodrinor, paramalor dhe malor, nga afërsia me Detin Adriatik si dhe nga liqeni i Shkodrës. Karakterizohet nga një klimë mesdhetare me dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Në dimër fryn era e murlanit (erë lokale), e ftohtë, e fortë dhe e thatë, ndërsa në fund të vjeshtës fryn era e shirokut, që shoqërohet me reshje dhe fryrjen e lumenjve. Sasia e reshjeve në këtë qytet është e madhe. Mesatarisht bie 2500 mm shi në vit, pra një nga zonat më të lagështa të Shqipërisë. Muaji më i ftohtë i vitit eshte muaji janar, ndërsa muaji më i nxehtë i vitit është muaji korrik. Reshjet e deborës bien rrallë, ndërsa ngricat shënohen zakonisht në fundin e vitit.

Tabela 4 Të dhëna klimatike

Temp.mes. vjetore	15.3 ^{0} C	Orë me diell në vit	2600
Temp.mes. Janar	4.7 ^{0} C	Vlefta mes. Ngrohtësisë	50.24 Kkal/cm^2
Temp.mes. Korrik	26.0 ^{0} C	Lagështia mes. Vjetore	66 %
Temp.max. shekullit	43.0 ^{0} C	Lagështia min. Gusht	53 %
Temp.min. shekullit	- 22.0 ^{0} C	Lagështia max. Nentor	77 %

Temp.mes. ujit liqenit	16.4 ^{0} C	Ditë dëbore mes. Vjetore	2 - 3
Sasia mes. vjetore reshjeve	**1700 mm**	Shpejtësia e erës	deri 25 - 45 m/s
Sasia max. vjetore reshjeve	**2500 mm**	Drejtimi i erës, kryesisht	Verilindore , jugore



Grafik i shperdnarjes se rreshjeve ne sezonin me te lagesht per periudhen 1960-2010.

2.7. Profili i forcës së punës në Bashkine e Shkodres

Punësimi: Për tre-mujorit të II 2016 rezulton se numri i të punësuarve në Bashkinë Shkodër është 25,058 persona, nga të cilat 8,021 punonjës janë të punësuar në sektorin publik dhe 17,037 punonjës në sektorin privat. Numri më i madh i të punësuarve është në qytetin Shkodër, ndjekur nga njësia administrative Rrethina. Ndërsa njësitë administrative me numrin më të ulët të punësimit janë Postriba, Pulti, Shale dhe Shosh. Megjithatë vlerësimi real i numrit të punësuarve në vend vështirësohet për shkak mos deklarimi nga personat që ushtrojnë veprimtari ekonomike jo bujqësore/bujqësore por që nuk figurojnë të regjistruar. Prandaj mendohet se ky numër punësimi është edhe më i lartë.

Një dukuri e tillë është e lidhur me lëvizjet migruese e cila ka sjellë një ulje të numrit të popullsisë në zonat rurale krahasuar me periudhën e fillim viteve '90 duke çuar në krijimin e qendrave urbane me dendësi popullsie deri në 230.18 banorë/ km² (Bashkia Shkodër) dhe zona më pak tërheqëse për banim me dendësi prej 4.4 banorë/ km² (Shale, Shosh, Pult). Kjo reflekton edhe përqendrimin ekonomik drejt qytetit Shkodër. Ndërveprim të dendur me qytetin e Shkodrës rezultojnë të kenë NjA. Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi etj.

Struktura e punësimit sipas sektorëve:

Struktura e punësimit sipas sektorëve i referohet periudhës gjatë viteve 2015 - 2016:

- 32 % e punëtorëve janë të punësuar në sektorin publik;
- 68% e punëtorëve janë të punësuar në sektorin privat.

3. INFORMACION PËRSHKRIMOR PËR KANALET KULLUESE TË SHKODRËS

Zona e Jugore e territorit të Bashkisë Shkodër, karakterizohet nga një zhvillim i shpejtë ekonomik, dominuar nga ai bujqësor dhe blegtoral, bashkëgjitur edhe me atë turistik, kryesisht bregdetar. Ky zhvillim i vrullshëm, si kudo në Shqipëri, është shoqëruar edhe me një urbanizim të egër dhe abuziv, duke ndikuar në zënien e tokës, veçanërisht asaj bujqësore me ndërtime të reja dhe duk modifikuar në mënyrë të parikuperueshme edhe sistemet e dikurshme të kullimit. Njëkohësisht zona është nën ndikimin e pothuajse të përvitshëm dhe të shtrirë në kohë te përmbytjeve.

Nisur nga kushtet e mësiperme, kjo zonë trashëgon një rrjet të dendur kullues, i cili aktualisht, mund të konsiderohet funksional në 50% të shtrirjes së tij. Në zonë, shtrihen të tre tipet e kanaleve kulluese, të para, të dyta dhe të treta, mirëmbajtja e të cilëve, është realizuar vetëm në rastet dhe kushtet e emergjencave, kryesisht menjëherë, pas përmbytjeve të viteve 2010-2011. Ndërhyrjet e tjera, kanë sporadike dhe jo efikase.

Procesi i reformës territorial, një proces tej i rëndësishëm inicioi fillimisht me krijimin e Agjencisë për Zbatim të Reformës Territoriale miratuar me *VKM nr.83 datë 28.01.2015* "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për zbatim të Reformës Territoriale[2]".

Si vazhde e reformave vjen Miratmi me VKM Korrik/2015 i "Strategjise kombetare ndersektoriale per Decetralizimin dhe Qeverisjen Vendore" dhe *Urdhëri i Kryeministrit nr.127 datë 16.09.2015* "Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore "që parashikonte masat dhe afatet për transferimin e funksioneve të reja vendore.

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015-2020) bën thirrje për fuqizimin e qeverive lokale, forcimin e demokracisë dhe përmirësimin e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve.[3]

Gjashtë funksione të reja janë transferuar në qeverinë lokale në vitin 2016, në përputhje me Ligjin për Qeverisjen Lokale, përfshirë personelin e arsimit parashkollor dhe të mesëm, menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, menaxhimin e rrugëve rurale, menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dytësore **dhe menaxhimin e kullimit,** menaxhimin e shërbimeve sociale dhe zjarrin mbrojtje dhe shpëtim.

Transferimi nuk ka qenë i qetë. Procesi nuk ndodhi në çast dhe është ende në vazhdim për disa funksione. Ekzistojnë çështje rreth përfundimit të kornizës ligjore për transferimin, ka probleme të mbetura institucionale për të zgjidhur, ka nevojë për kapacitetet lokale për t'u marrë me funksionet e reja dhe një planifikim të duhur për menaxhimin e këtyre funksioneve në mënyrë efektive.[4]

[2] Shih me tej Fletoren Zyrtare nr.14, viti 2015, fq 548
[3] Republic of Albania, 2015. National Crosscutting Strategy for Decentralization and Local Governance 2015-2020
[4] STAR Program, "Raport on Inception phase" 2017, p.57

Bashkitë tashme janë përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe sigurinë e digave të rezervuarëve që përdoren për ujitje dhe që u janë transferuar bashkive. Bashkitë e reja kanë detyrë tashmë në sektorin e ujitjes dhe kullimit pastrimin e kanaleve të para, të dyta dhe të treta, veprat e artit, rehabilitimin e tyre, pastrimin e rrjetit të kanaleve kulluese.

Me marrjen e inventarit fizik të kanaleve kulluese **të dyta dhe treta,** Bashkisë Shkodër, i janë shtuar detyrimet për administrimin e një territori mjaft të gjerë dhe me një kompleksitet të madh problematikash, në administrimin e ujrave. Pjesa më e madhe e problematikave, nuk mund të thuhet se varet direkt nga Bashkia, *veçanërisht problemi i menaxhimit të përmbytjeve periodike,* shkarkimeve të kontrolluara dhe jo, të ujrave të basenit të lumit Drin, të prurjeve të liqenit të Shkodrës, apo prurjet e vrullshme të lumejve Kir dhe Gjadër. Shtrirja në kohë, e efekteve të përmbytjeve, është e shtrirë gjatë gjithë sezonit të lagësht, duke ndikuar në mbajtjen lart nivelit të ujrave nëntokësore.

Ndikimet në bujqësi dhe degët e tjera ndihmese ekonomike, përfshirë dhe kushtet e jetesës, janë dhe mbeten të mëdha dhe të përhershme, perderisa të mos ketë një sistem të administrimit të mirë të ujrave, për këtë zonë shumë specifike hidrike, në nivel kombëtar, rajonal dhe shumë më gjerë.

Bashkia është përgjegjëse për administrimin, shfrytezimin dhe mirëmbajtjen e infrastruktures së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të saj, sipas menyrës së përcaktuar me ligj.

Në vijim të zbatimit të reformes territoriale, është miratuar ligji 139|2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i cili përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e njësive të qeverisjes vendore. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohen dhe funksionet e Bashkisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Në përmbushje të këtij funksioni, Bashkia Shkoder ka organizuar punen per evidentimin e gjendjes se kanaleve ujitese (KU) dhe **kanaleve kulluese (KK),** nga ku rezulton se, gjendja është e ndryshueshme sipas njësive administrative, kryesisht atyre shtrihen në pjesën jugore të qytetit Shkodër.

Nga inventari i kanaleve të dyta dhe treta ujitës, për të cilët, në bazë të ligjit, ngarkohen për administrim bashkitë, Bashkia Shkodër ka marrë në dorëzim gjithsejt 213 km Kanale Ujitëse (KU), nga të cilët, 37 km prej tyre janë në funksion, ndërsa pjesa tjetër prej 176 km është totalisht jashtë funksionit.

Po ashtu nga inventari i marrë nga Bashkia Shkoder për kanalet kullues (KK-II dhe KK-III) rezulton se gjatësia totale është gjithsejt **729. 8 km.**

Në shtrirjen jugore të bashkisë Shkodër, janë marrë në inventar 612.9 km kanale kulluese, prej të cilëve **106.5 km** kanale te dyta dhe 506.4 **km** kanale te treta kulluese. Nga verifikimet në terren, rezulton se të pastruara dhe funksionale janë **10 km**, kanale kulluese

te dyta dhe pjesa tjetër prej 96.5 km rezulton të jetë 35% e bllokuar. Kanalet e treta kulluese me nje gjatesi prej **506.4 km** rezultojne te bllokuara ne **40%** të tërësisë së tyre.

3.1. Çfarë eshte transferuar dhe cilat janë problematikat. Gjendja ne pergjithesi dhe situata me bazen teknike .

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë transferuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Bashkia Shkodër, në zbatim te VKM nr 1108, date 30.12.2015 dhe Udhezuesit te AZRT nr 540/1, date 31.12.2015, ka ngritur grupin e punës per marrjen në dorëzim të funksionit te ujitjes dhe kullimit me Urdherin e brendshem të Kryetar-es së Bashkisë nr 3, date 12.01.2016.

Bashkia Shkodër me Urdherin nr 14, date 19.01.2016 ka krijuar institucionin “Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore” i cili merret me shërbimin e mirembajtjes së kanaleve vaditese dhe kulluese.

Krijimi i kësaj strukture, si institucion varësie, me 12 punonjës, pagesa e të cilëve kryhet nga transferte specifike dhe të ardhurat e Bashkisë Shkodër sipas tabelës së mëposhtme. Vlen te theksohet se numri 12 ne structure I pergjigjet vaditjes edhe kullimit. Ajo qe do jete e nevojshme ne analize per te llogaritur kostot indirekte (administrativ, paga dhe sig shoqerore)ne menyre qe te kemi te qarte analizen e structures se kostos ne pergjithesi.

Përmes koordinimit të realizuar nga Agjensia Zbatuese e Reformës Territoriale në shkurt të vitit 2016, u pezullua transferimi i personelit, duke u anulluar pagesat e muajit janar 2016 e duke shkaktuar probleme në transferimin e këtij funksioni. Me shkresen nr 2571, date 03.03.2016 ”Informacion mbi pezullimin e procesit te transferimit te punonjesve te Bordit te Kullimit tek Bashkia” është vene ne dijeni Bordin Rajonal te Kullimit Lezhe, dhe Prefektin e Qarkut Shkoder per procedurën e ndjekur dhe problematikën e sjellë.

Eshte komunikuar vazhdimisht me Ministrine e Bujqesise, AZRT dhe Prefektin e Qarkut per ecurine e punes dhe veshtiresite ne marrjen ne dorezim te aseteve nga Drejtoria e Bordit Rajonal te Kullimit. Një ndër problemet e trashëguara lidhet me titujt e pronësisë të aseteve në proces transferimi. Sipas VKM jane per transferim 10200 m2 truall, i cili aktualisht rezulton i zene, i rrethuar. Kemi kërkuar me shkresen nr 1968, date 19.02.2016 drejtuar Zyres Vendore te Regj Pasurive te Paluajtshme për shprehje juridike te statusit te prones per kete institucion dhe me pergjigjen e tyre nr 912/1, date 08.3.2016 rezulton qe i gjithe territori i ndarrmarrjes ka kaluar ne pronesi private, i regjistruar ne muajin qershor 2015. Njekohesisht edhe ndertesa Ofiçine është brenda territorit të rrethuar dhe

zyrat+magazinë janë të regjistruara ne ZRPP me te drejte parablerjeje. Procesi i marrjes në dorezim i aseteve eshte perfunduar me datën 31.05.2016.

Bashkia Shkodër ka marrë në dorëzim në inventarin e saj kanale ujitese 213 km nga këto 37 km në funksion dhe 176 km jo funksional, kanale kullues gjithsejt 729.8 km nga të cilët 129, 8 km kanale të dyta dhe 600 km kanale të treta kulluese. Në pjesën më të madhe të këtij inventari gjendja është jo funksionale për mungesë të mirëmbajtjes dhe pastrimit ndër vite.

Qeveria në vitin 2016 ka akorduar një fond me vlere fillesatare prej 33,702,000 Lekë për blerjen e dy eskavatorëve në zbatim të VKM Nr 90 datë 04.02.2016. Prokurimi është realizuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Bashkia Shkodër, drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ka përfituar nga ky investim dy eskavatorë, në vlerë në total 25,402,000 lekë. Këto mjete akoma janë dorëzuar në inventarin e Bashkisë Shkodër dhe tashmë janë në funsion për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese.

Me fondin prej 10 milione leke, te vene ne dispozicion me VKM nr.90,dt.4.2.2016 per rehabilitimin e pjesshëm të skemës ujitëse Gur i Zi- Juban është realizuar ndërhyrja emergjente në një segmet pjesor, pasi vlera e plotë e projektit është 125 milione lekë.

Gjatë vitit 2016 Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP dhe Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ka realizuar:

- Evidentimin e gjendjes së kanaleve Ujitëse (K.U.) dhe Kulluese (K.K.) ,
- Hartimin e disa projekteve të ndërhyrjes për pastrim/reabilitim të K.K.
- Ndërhyrjen më pastrim dhe vendosjen në gjendje funksionale të K.K.

Ndodhur përballë situatës për ndërhyrje urgjente dhe/apo periodike në sistemin ujitës/kullues dhe mungesën e mjeteve u vlerësuan dhe zbatuan ndërhyrje alternative nëpërmjet bashkëpunimit me Bordin Rajonal të Kullimit. Gjithashtu ndërhyrje të rëndësishme në rrjetin kullues janë kryer nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të projekteve me financim të transfertave specifike për vënien në efiçensë të Kanaleve të Dyta Kulluese.

Kështu gjatë vitit 2016 janë realizuar ndërhyrje në sistemin kullues: janë pastruar dhe mirëmbajtur gjithsej 17.5 km KK., nga këto 15.1 km KKII dhe 2.4 km KKIII. Sipërfaqja e përmirësuar e kullimit për këtë punë të realizuar është 1,015 Ha. Volumi i punimeve për pastrimin e KK 60,310 m3.

.

Tabela No.6 Informacion përmbledhës për sistemin kullues, sipas inventarit të transferuar në Bashkinë Shkodër në **NJA Velipojë, Dajç, Ana e Malit, Guri i Zi, Bërdicë.**

No		Kanale te Para (ml)	Kanale te Dyta (ml)	Kanale te Treta (ml)	siper faqe te Kanaleve te Para	siper faqe te Kanaleve te II	siper faqe te Kanaleve te III	Seksioni i gjalle e kanalit 1	Seksioni i gjalle e kanalit II	Seksioni i gjalle e kanalit III	% e zene e Kanalit te 1	% e zene e Kanalit te 2	% e zene e Kanalit te 3	Vepra arti te Kanalit te 1	Vepra arti te Kanalit te 2	Vepra arti te Kanalit te 3	Vepra arti te demtuara te Kanalit te I	Vepra arti te demtuara te Kanalit te II	Vepra arti te demtuara te Kanalit te III	Siperfaqene Haqe i sherben Kanalii 1	Siperfaqene Haqe i sherben Kanalii 2	Siperfaqene Haqe i sherben Kanalii 3
		ml	Ml	ml	m2	m2	m2	m2	m2	m2	%	%	%	No.	No.	No.	No.	No.	No.	Ha	Ha	Ha
1	Njesia adm DAJC	21, 000	24,000	120,000	308, 000	144,000	336,000	16.25	8.25	2.08	15%	36%	40%	13	16	210	2	2	10	2,510	2,510	2,510
2	Njesia adm Velipoje	26, 800	14,600	141,400	885,000	200,000	420,000	76.80	12.50	2.50	12%	30%	39%	11	30	240	1	6	33	2,935	2,935	2,935
3	Njesia adm Berdice	13,200	22,800	120,000	360,000	114,000	240,000	21.50	8.40	2.25	17%	37%	40%	20	40	200	4	10	74	1,960	1,960	1,960

4	Njesia adm Ana e Malit	10,000	14,700	60,000	176,000	90,000	132,000	15.00	9.35	1.70	14%	38%	39%	16	15	130	4	5	43	1,300	1,300	1,300
5	Njesia adm Guri i Zi	13,600	20,400	65,000	136,000	180,000	143,000	21.00	8.75	1.70	16%	36%	38%	12	20	120	3	7	34	1,394	1,394	1,394
GJITHSEJ		**84.600**	**106.500**	**506.400**	**1.557.000**	**728.000**	**1.271.000**				15%	35%	40%	72	121	900	14	30	194	**10,099**		

4. Baza Ligjore dhe Institucionale

Baza ligjore qe perfshin ligjin organik, legjin sektorial, strategjite dhe aktet rregullativ ne nivel kombetar dhe rajonal eshte shume e gjere dhe shume dinamike. Do thote se ne vite ka ndryshuar dendur doke sjellur jo ne pak raste edhe konfuzion ne strukturat e ofrimit te ketij sherbimi. Edhe aktualisht pavaresisht se ligji sektorial u miratua ne prill 2017 nuk eshte shoqeruar akoma me aktet neligjore te mjaftueshme. Mjafotn te sjellim nje fakt qe strategjia per ujitjen e kullimin eshte bere pasi ka dale ligji sektorial (Ligji No.24/2017).

4.1. Baza ligjore

Me poshte po radhisim jo ne menyre shteruese aktet ligjore dhe nenligjore qe afektojne funksionin e kullimit.

- *Ligji nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore",*
- *Ligji nr. 8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin" i ndryshuar me Ligjin nr.9860, datë 21.1.2008. Bazuar në këtë ligj kane funksionuar Bordet Rajonale te Kullimit ne varesi te MBZHRAU.*
- *Ligji nr.8681/2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbvajtjen e digave dhe dambave",*
- *Ligj Nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit"*
- *VKM nr.147/2004 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave".*
- *VKM nr.1107/2015 "Për krijimin e bordeve rajonale të Kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë",*
- *VKM nr.1108/2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit",*
- *Urdhëri nr.287/2006 "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit dhe administrimit të stacioneve të kullimit me elektropompa aksiale hidrovoret",*
- *Urdhër i Ministrit të Financave nr.47 datë 30.06.2015 "Për procedurat e mbylljes së llogarive të NJQV që do të shkrihen"*

Ligji 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit" ka si qellim ndertimin e kuadrin institucional e funksional ne linje me politiken kombetare per ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga permbytja,kuadrin ligjor per krijimin dhe funksionimin e strukturave pergjegjese dhe detyrat e tyre,si dhe te rregulloje, transferimin, mirmbajtjen dhe perdorimin e infrastruktures.

Tre nga objektivat kryesore të ligjit janë: a) permiresimi i menaxhimit të sistemeve te ujitjes dhe kullimit te transferuara te Bashkite dhe OPU; b) rritja e rolit te drejtorive te ujitjes dhe kullimit te cilat menaxhojne infrastrukturen kryesore në nivel lokal dhe

rajonal; c)Rritja e produktivitetit bujqesor, nëpërmjet plotësimit të nevojave me ujë të fermerëve, si dhe përmirësimi i kullimit dhe mbrojtja nga përmbytja të të gjithë zonave që mund të kullohen.

4.2. Baza institucionale

1. Bashkia Shkoder, shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi, që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit.
2. Bashkia shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes, në mënyrë të tillë që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar.
3. Bashkia, brenda zonës së vet të shërbimit:

a) pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitëse;

b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe të kullimit;

c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit, si dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në zonat e banuara;

ç) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe, kur është e nevojshme, kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre;

d) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të;

dh) merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet;

e) përmbush detyrat, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore;

ë) monitoron sasinë e ujit që përdor gjatë një viti.

4. Bashkia bashkëpunon për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit me drejtorinë përkatëse të ujitjes dhe të kullimit, në rastet kur kjo e fundit administron infrastukturën kryesore në këto sisteme.

5. STRUKTURA E TE MBJELLAVE DHE IMPAKTI EKONOMIK QE SJELL KULLIMI

Duke iu referuar të dhënave ekzistuese nga Drejtoria e Bujqësisë së qarkut Shkodër, tabela më poshtë jep informacion mbi efektet në prodhim dhe në të ardhura pas ndërhyrjeve në sistemin e kullimit në pesë Njësi admininstrative, në pjesën jugore të Bashkisë Shkodër.

Ky vlerësim paraprak merr në konsideratë të dhënat mbi prodhimin aktual, të dhënat mbi pritshëmrinë e prodhimit në vitin 2017 e në vijim, me çmimet aktuale të tregut dhe të pandryshueshme.

Sipas llogaritjeve te bera nga Drejtoria e bujqesise me cmime reference per prodhimet e nje databaze te te dhenave formale del qe nqs toka kullon pas nderhyrjeve, te ardhurat rriten me 30% ose ne vlere absolute me rreth **38 Miljon leke/vit.**

Veme ne dukse se kjo llogaritje nuk ka parasyshe ekonomine informale, te paraportuar e cila ne vlersimin e eksperteve eshte shume e larte qe do thote se perfitimet e fermereve jane akoma me shume se sa thame me siper nese rrjeti do funksionoje ne parametra optimal.

Po keshtu nuk jane marre parasyshe toka te pambjella si rezultat i shkurajimi tte fermereve per te mbjelle nga shkaku i rrezikut te permbytjeve, mos kullimit apo kullimit te keq.

Tabela No. 7: Vlerësimi i rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe të hyrave sipas NjA-ve dhe kulturave, në nën Shkoders, në vitin 2107

		Prodhimi (kv/vit)				Çmimi viti 2016, tregu me shumice (All/kv)	Të hyra monetare (All)				Vlerë e shtuar (All)		
NjA	Kultura	Total prodhimi aktual (kv/vit)	Pritshmëri rritje prodhimi 2017, e në vazhdim (kv/vit)*10%	Pritshmëri rritje prodhimi 2017, e ne vazhdim (kv/vit)*20%	Pritshmëri rritje prodhimi 2017, e në vazhdim (kv/vit)*30%		Të hyra aktuale (All), deri 2017	Të hyra pritshme, (All) (rritje standart prodhimi 10%)	Të hyra pritshme, (All) (rritje standart prodhimi 20%)	Të hyra pritshme, (All) (rritje standart prodhimi 30%)	Vlerë e shtuar (All), (rritje standart prodhimi 10%)	Vlerë e shtuar (All), (rritje standart prodhimi 20%)	Vlerë e shtuar (All), (rritje standart prodhimi 30%)
Ana Malit	Grure	81.0	89.1	97.2	105.3	350.0	28,350.0	31,185.0	34,020.0	36,855.0	2,835.0	5,670.0	8,505.0
	perime te thata	2,030.0	2,233.0	2,436.0	2,639.0	45.0	91,350.0	100,485.0	109,620.0	118,755.0	9,135.0	18,270.0	27,405.0
	Fasule	120.0	132.0	144.0	156.0	1,700.0	204,000.0	224,400.0	244,800.0	265,200.0	20,400.0	40,800.0	61,200.0
	peme frutore	265.2	291.7	318.2	344.8	1,200.0	318,240.0	350,064.0	381,888.0	413,712.0	31,824.0	63,648.0	95,472.0
	agrume	399.9	439.9	479.9	519.9	800.0	319,920.0	351,912.0	383,904.0	415,896.0	31,992.0	63,984.0	95,976.0
	Vreshta	500.0	550.0	600.0	650.0	900.0	450,000.0	495,000.0	540,000.0	585,000.0	45,000.0	90,000.0	135,000.0
	Patate	2,040.0	2,244.0	2,448.0	2,652.0	400.0	816,000.0	897,600.0	979,200.0	1,060,800.0	81,600.0	163,200.0	244,800.0
	perime te njoma	21,894.0	24,083.4	26,272.8	28,462.2	50.0	1,094,700.0	1,204,170.0	1,313,640.0	1,423,110.0	109,470.0	218,940.0	328,410.0
	Miser	4,340.0	4,774.0	5,208.0	5,642.0	280.0	1,215,200.0	1,336,720.0	1,458,240.0	1,579,760.0	121,520.0	243,040.0	364,560.0
	bostane	15,950.0	17,545.0	19,140.0	20,735.0	250.0	3,987,500.0	4,386,250.0	4,785,000.0	5,183,750.0	398,750.0	797,500.0	1,196,250.0
	perime sera	4,840.0	5,324.0	5,808.0	6,292.0	1,000.0	4,840,000.0	5,324,000.0	5,808,000.0	6,292,000.0	484,000.0	968,000.0	1,452,000.0
Berdice	Grure	4,960.0	5,456.0	5,952.0	6,448.0	350.0	1,736,000.0	1,909,600.0	2,083,200.0	2,256,800.0	173,600.0	347,200.0	520,800.0
	Miser	35,000.0	38,500.0	42,000.0	45,500.0	280.0	9,800,000.0	10,780,000.0	11,760,000.0	12,740,000.0	980,000.0	1,960,000.0	2,940,000.0
	perime te njoma	33,525.0	36,877.5	40,230.0	43,582.5	50.0	1,676,250.0	1,843,875.0	2,011,500.0	2,179,125.0	167,625.0	335,250.0	502,875.0
	bostane	18,104.0	19,914.4	21,724.8	23,535.2	250.0	4,526,000.0	4,978,600.0	5,431,200.0	5,883,800.0	452,600.0	905,200.0	1,357,800.0
	Patate	2,100.0	2,310.0	2,520.0	2,730.0	400.0	840,000.0	924,000.0	1,008,000.0	1,092,000.0	84,000.0	168,000.0	252,000.0
	perime te thata	1,848.0	2,032.8	2,217.6	2,402.4	45.0	83,160.0	91,476.0	99,792.0	108,108.0	8,316.0	16,632.0	24,948.0
	perime sera	914.3	1,005.7	1,097.2	1,188.6	1,000.0	914,300.0	1,005,730.0	1,097,160.0	1,188,590.0	91,430.0	182,860.0	274,290.0
	Vreshta	840.0	924.0	1,008.0	1,092.0	900.0	756,000.0	831,600.0	907,200.0	982,800.0	75,600.0	151,200.0	226,800.0

	Ullinj	142.2	156.4	170.6	184.9	1,200.0	170,640.0	187,704.0	204,768.0	221,832.0	17,064.0	34,128.0	51,192.0
	peme frutore	76.4	84.0	91.7	99.3	1,200.0	91,680.0	100,848.0	110,016.0	119,184.0	9,168.0	18,336.0	27,504.0
	Fasule	72.0	79.2	86.4	93.6	1,700.0	122,400.0	134,640.0	146,880.0	159,120.0	12,240.0	24,480.0	36,720.0
Dajç	Grure	1,530.0	1,683.0	1,836.0	1,989.0	350.0	535,500.0	589,050.0	642,600.0	696,150.0	53,550.0	107,100.0	160,650.0
	Miser	43,166.8	47,483.5	51,800.2	56,116.8	280.0	12,086,704.0	13,295,374.4	14,504,044.8	15,712,715.2	1,208,670.4	2,417,340.8	3,626,011.2
	perime te njoma	23,896.0	26,285.6	28,675.2	31,064.8	50.0	1,194,800.0	1,314,280.0	1,433,760.0	1,553,240.0	119,480.0	238,960.0	358,440.0
	bostane	16,929.0	18,621.9	20,314.8	22,007.7	250.0	4,232,250.0	4,655,475.0	5,078,700.0	5,501,925.0	423,225.0	846,450.0	1,269,675.0
	Patate	783.0	861.3	939.6	1,017.9	400.0	313,200.0	344,520.0	375,840.0	407,160.0	31,320.0	62,640.0	93,960.0
	perime te thata	569.7	626.7	683.6	740.6	45.0	25,636.5	28,200.2	30,763.8	33,327.5	2,563.7	5,127.3	7,691.0
	Fasule	539.0	592.9	646.8	700.7	1,700.0	916,300.0	1,007,930.0	1,099,560.0	1,191,190.0	91,630.0	183,260.0	274,890.0
	agrume	156.0	171.6	187.2	202.8	800.0	124,800.0	137,280.0	149,760.0	162,240.0	12,480.0	24,960.0	37,440.0
	Vreshta	148.0	162.8	177.6	192.4	900.0	133,200.0	146,520.0	159,840.0	173,160.0	13,320.0	26,640.0	39,960.0
	Ullinj	140.7	154.8	168.8	182.9	1,200.0	168,840.0	185,724.0	202,608.0	219,492.0	16,884.0	33,768.0	50,652.0
	peme frutore	127.2	139.9	152.6	165.4	1,200.0	152,640.0	167,904.0	183,168.0	198,432.0	15,264.0	30,528.0	45,792.0
	Grure	2,944.0	3,238.4	3,532.8	3,827.2	350.0	1,030,400.0	1,133,440.0	1,236,480.0	1,339,520.0	103,040.0	206,080.0	309,120.0
Guri i Zi	perime te njoma	52,685.0	57,953.5	63,222.0	68,490.5	50.0	2,634,250.0	2,897,675.0	3,161,100.0	3,424,525.0	263,425.0	526,850.0	790,275.0
	bostane	22,400.0	24,640.0	26,880.0	29,120.0	250.0	5,600,000.0	6,160,000.0	6,720,000.0	7,280,000.0	560,000.0	1,120,000.0	1,680,000.0
	Miser	11,020.0	12,122.0	13,224.0	14,326.0	280.0	3,085,600.0	3,394,160.0	3,702,720.0	4,011,280.0	308,560.0	617,120.0	925,680.0
	perime te thata	6,762.0	7,438.2	8,114.4	8,790.6	45.0	304,290.0	334,719.0	365,148.0	395,577.0	30,429.0	60,858.0	91,287.0
	Patate	4,400.0	4,840.0	5,280.0	5,720.0	400.0	1,760,000.0	1,936,000.0	2,112,000.0	2,288,000.0	176,000.0	352,000.0	528,000.0
	Vreshta	4,320.0	4,752.0	5,184.0	5,616.0	900.0	3,888,000.0	4,276,800.0	4,665,600.0	5,054,400.0	388,800.0	777,600.0	1,166,400.0
	Ullinj	1,755.0	1,930.5	2,106.0	2,281.5	1,200.0	2,106,000.0	2,316,600.0	2,527,200.0	2,737,800.0	210,600.0	421,200.0	631,800.0
	Duhan	1,276.8	1,404.5	1,532.2	1,659.8	3,500.0	4,468,800.0	4,915,680.0	5,362,560.0	5,809,440.0	446,880.0	893,760.0	1,340,640.0
	peme frutore	480.2	528.2	576.2	624.3	1,200.0	576,240.0	633,864.0	691,488.0	749,112.0	57,624.0	115,248.0	172,872.0
	Fasule	236.0	259.6	283.2	306.8	1,700.0	401,200.0	441,320.0	481,440.0	521,560.0	40,120.0	80,240.0	120,360.0

Velipojë	Grure	7,560.0	8,316.0	9,072.0	9,828.0	350.0	2,646,000.0	2,910,600.0	3,175,200.0	3,439,800.0	264,600.0	529,200.0	793,800.0
	Miser	24,100.0	26,510.0	28,920.0	31,330.0	280.0	6,748,000.0	7,422,800.0	8,097,600.0	8,772,400.0	674,800.0	1,349,600.0	2,024,400.0
	perime te njoma	12,688.0	13,956.8	15,225.6	16,494.4	50.0	634,400.0	697,840.0	761,280.0	824,720.0	63,440.0	126,880.0	190,320.0
	Patate	11,495.0	12,644.5	13,794.0	14,943.5	400.0	4,598,000.0	5,057,800.0	5,517,600.0	5,977,400.0	459,800.0	919,600.0	1,379,400.0
	bostane	10,944.0	12,038.4	13,132.8	14,227.2	250.0	2,736,000.0	3,009,600.0	3,283,200.0	3,556,800.0	273,600.0	547,200.0	820,800.0
	perime sera	1,862.6	2,048.9	2,235.1	2,421.4	1,000.0	1,862,600.0	2,048,860.0	2,235,120.0	2,421,380.0	186,260.0	372,520.0	558,780.0
	perime te thata	1,005.0	1,105.5	1,206.0	1,306.5	45.0	45,225.0	49,747.5	54,270.0	58,792.5	4,522.5	9,045.0	13,567.5
	agrume	952.0	1,047.2	1,142.4	1,237.6	800.0	761,600.0	837,760.0	913,920.0	990,080.0	76,160.0	152,320.0	228,480.0
	Ullinj	520.0	572.0	624.0	676.0	1,200.0	624,000.0	686,400.0	748,800.0	811,200.0	62,400.0	124,800.0	187,200.0
	Fasule	417.6	459.4	501.1	542.9	1,700.0	709,920.0	780,912.0	851,904.0	922,896.0	70,992.0	141,984.0	212,976.0
	peme frutore	241.5	265.7	289.8	314.0	1,200.0	289,800.0	318,780.0	347,760.0	376,740.0	28,980.0	57,960.0	86,940.0
Nen Shkodër	Perime te thata	12,214.7	13,436.2	14,657.6	15,879.1	45.0	549,661.5	604,627.7	659,593.8	714,560.0	54,966.2	109,932.3	164,898.5
	Agrume	1,507.9	1,658.7	1,809.5	1,960.3	800.0	1,206,320.0	1,326,952.0	1,447,584.0	1,568,216.0	120,632.0	241,264.0	361,896.0
	Peme frutore	1,190.5	1,309.6	1,428.6	1,547.7	1,200.0	1,428,600.0	1,571,460.0	1,714,320.0	1,857,180.0	142,860.0	285,720.0	428,580.0
	Fasule	1,384.6	1,523.1	1,661.5	1,800.0	1,700.0	2,353,820.0	2,589,202.0	2,824,584.0	3,059,966.0	235,382.0	470,764.0	706,146.0
	Duhan	1,276.8	1,404.5	1,532.2	1,659.8	3,500.0	4,468,800.0	4,915,680.0	5,362,560.0	5,809,440.0	446,880.0	893,760.0	1,340,640.0
	Vreshta	5,808.0	6,388.8	6,969.6	7,550.4	900.0	5,227,200.0	5,749,920.0	6,272,640.0	6,795,360.0	522,720.0	1,045,440.0	1,568,160.0
	Grure	17,075.0	18,782.5	20,490.0	22,197.5	350.0	5,976,250.0	6,573,875.0	7,171,500.0	7,769,125.0	597,625.0	1,195,250.0	1,792,875.0
	Perime te njoma	144,688.0	159,156.8	173,625.6	188,094.4	50.0	7,234,400.0	7,957,840.0	8,681,280.0	9,404,720.0	723,440.0	1,446,880.0	2,170,320.0
	Perime sera	7,616.9	8,378.6	9,140.3	9,902.0	1,000.0	7,616,900.0	8,378,590.0	9,140,280.0	9,901,970.0	761,690.0	1,523,380.0	2,285,070.0
	Patate	20,818.0	22,899.8	24,981.6	27,063.4	400.0	8,327,200.0	9,159,920.0	9,992,640.0	10,825,360.0	832,720.0	1,665,440.0	2,498,160.0
	Bostane	84,327.0	92,759.7	101,192.4	109,625.1	250.0	21,081,750.0	23,189,925.0	25,298,100.0	27,406,275.0	2,108,175.0	4,216,350.0	6,324,525.0
	Ullinj	22,120.3	24,332.3	26,544.4	28,756.4	1,200.0	26,544,360.0	29,198,796.0	31,853,232.0	34,507,668.0	2,654,436.0	5,308,872.0	7,963,308.0
	Miser	117,626.8	129,389.5	141,152.2	152,914.8	280.0	32,935,504.0	36,229,054.4	39,522,604.8	42,816,155.2	3,293,550.4	6,587,100.8	9,880,651.2
	Totali	**437,654.5**	**481,420.0**	**525,185.4**	**568,950.9**		**124,950,765.5**	**137,445,842.1**	**149,940,918.6**	**162,435,995.2**	**12,495,076.6**	**24,990,153.1**	**37,485,229.7**

Pritshmëria e rritjes së hyrjeve monetare, justifikohet me faktin, se reduktohen disa humbje të prodhimit gjatë periudhës së lagësht, veçanërisht për kulturat e dimrit. Efekti më pozitiv, do ishte, në futjen e hershme në prodhim të gjithë nënshkodrës, për produktet e freskëta të pranverës dhe të tokës. Një perspektive e mirë do ishte, edhe hershmeria e produkteve të serave, ne tokë. Të dy sa sipër, janë prodhime, me vlerë të shtuar të lartë. Njëkohësisht, hamulloret, e vjeshtës, do ishin më të thata dhe me qëndrueshmëri më të gjatë në kohë dhe profilaksi të sigurt gjatë periudhës së dimrit. Mbajtja nën kontroll e bilanci ujor, do mundësonte direkt në rritjen e rendimenti për njësi, për të gjitha kulturat, qoftë të dimrit, qoftë pranverës dhe vjeshtës.

Në aspektet afatmesme dhe afatgjata, sistemi i mirë i kullimit do të ruante pjellorinë e tokës, mbrojtjen nga kripëzimi, ruajtjen e bilancit mikrobik të tokës dhe ajrimin e mirë të saj.
Lagështia e tepërt, është, burimi i sëmundjeve të ndryshme dhe një sistem i mirë kullimi, do parandalonte, një profilaksi të mirë të sëmundjeve, rrjedhimisht të kostove të larta të trajtimit të sëmundjeve të bimëve të stinëve.
Me fjalë të tjera, parandalimi i humbjeve të prodhimit, për shkak të kullimit, indirekt, do sillte, kursime monetare, në ekonomitë fermere, duke shtuar kursimet, apo duke reduktuar demshpërblimet, në rastet e qëndrimit të gjatë të ujit në tokë.

Një sistem i mirë kullues, shoqëruar me masat parandaluese të përmbytjeve, do kishte një ndikim direkt, në kushtet e jetesës edhe të pjesës tjetër e banorëve, që nuk merren domosdoshmërisht me aktivitete ekonomike bujqësore-blegtorale, që në çdo rast, kanë, një kosto financiare.

6. Klasifikimi i kanaleve ekzistuese

Kanalet kullues ndahen ne 3 grupe

1. Kanal kullues I (i pare ose kolektor)
2. Kanal kullues II (i dyte)
3. Kanal kullues III (I trete)

Mbulimi i sipërfaqeve që u shërbejnë sipas kategorive të kanaleve kulluese:

Tabela No.8

Emertimi	Siperfaqe (ha)
Kanal kullues I	**10 099**
Kanal kullues II	
Kanal kullues III	

Nga perpunimi I te dhenave te Tabeles No.6 dalin te dhenat sipas Figurave/grafikeve me poshte.

Figura 1: Kanale të para kulluese sipas Njësive Administrative km



Grafiku 2 **Kanale të II-ta kulluese sipas Njësive Administrative km**



Grafiku 3 **Kanale të treta kulluese sipas Njësive Administrative km**



Grafiku 4: Sipërfaqe e kanaleve kulluese sipas Njësive Administrative (në m2)



Grafiku 5 Raporti në % i zënies së kanaleve kulluese sipas kategorive për NjA



Tabela 9. Sipërfaqja në Ha që u shërben 1 ml kanal kullues, sipas kategorive, shtrirë në pesë Njësitë Administrative

	Kanale te Para Ha/ml	Kanale te Dyta Ha/ml	Kanale te Treta Ha/ml
Nja Administrative Dajc	0.12	0.1	0.02
Nja Administrative Velipoje	0.11	0.2	0.02
Nja Administrative Berdice	0.15	0.09	0.016
Nja Administrative Ana e Malit	0.13	0.09	0.02
Nja Administrative Guri i Zi	0.1	0.07	0.02

Grafiku 6. Kanale për një Ha tokë bujqësore sipas kategorisë dhe NjA-ve ml.



7. PËRSHKRIMI I GJENDJES PËR SKEMAT E KULLIMIT NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR

Klasifikimi i kanaleve egzistuese

Rrjeti i kanaleve kulluese per Bashkine Shkoder ka dy sisteme kullimi dhe ndahet ne 5 skema te veçanta

Sistemet e kullimit jane me rrjedhje te lire dhe me ngritje mekanike(hidrovore), skemat 1,2,3,4 jane skema me rrjedhje te lire ndersa skema 5 eshte me ngritje mekanike (hidrovor).

Skema 1:

Emertimi SH K- 1 Njësia Administrative Rrethinat **(Nuk eshte pjese e projektit)**

Gjatesia totale e kanaleve kulluese eshte 98 km,te ndara ne 23 km kanale te dyta dhe ne 75 km kanale te treta,vecori e kesaj skeme eshte se nuk ka kanal te pare kullues.

Kjo skeme mbulon territorin e Njesise Administrative Rrethina dhe nje pjese te zones perendimore te Bashkise Shkoder (zona e livadheve)

Kjo zone eshte mjaft e veshtire per nderhyrje ne pjesen me te madhe te saj pasi vitet e fundit eshte kthyer ne nje zone urbane (zone me perparesi legalizimi), pastrimi i kanaleve te dyta ne pjesen me te madhe duhet te konsiderohet me transport.

Kanalet e treta ne mjaft e raste nuk kane asnje gjurme, por edhe aty ku ekzistojne nderhyrja eshte shume e veshtire per shkak te zenies se bankinave te tyre ,ndertimeve pa kriter,linjave elektrike si dhe vendosjes ne mase te madhe te tumbinave ne shumicen e rasteve pa asnje parameter.

Skema 2

SHK-2 Njesia Administrative Guri i Zi

Bashkia Shkoder ka te gatshem nje projekt per pastrimin e te gjithe rrjetit kullues SHK-2

***Situata e Kanaleve kulluese te para**:* Situata e ketyre kanaleve paraqitet tejet e renduar, keto kanale jane te papastruar per me shume se 20 vite, jane nder kanalet kulluese te para me te papastruara ne te gjithe Bashkine Shkoder, kane nje prani te madhe grumbullime inertesh dhe bimesia eshte e dendur ne trajten e pemeve te rritura shume vjecare, bankina vende vende eshte e bllokuar, ka prani te madhe uji ne te gjith gjatesine e bashkimit te te dy kanaleve kullues.

***Situata e Kanaleve kullues te dyta**:* Gjendja e ketyre kanaleve nuk paraqitet e mire, nderhyrjet ne keto kanale kane qene sporadike, vetem ne vitin e fundit Bashkia Shkoder ka nderhyre ne disa prej tyre ne nje gjatesi prej 3.5 km, ne pjesen tjeter nderhyrja eshte mjaft

e domosdoshme, problematike kryesore mbetet zenia e bankinave te tyre si dhe ndertimet pa kriter te mbikalimeve mbi to jashte cdo parametri. Zenia eshte rreth 36%.

Situata e kanaleve kullues te treta: Ne keto kanale nuk eshte nderhyre prej 27 vitesh, nje pjese e tyre nuk kane asnje gjurme, ndersa pjesa tjeter funksionon pak ose aspak per shkak te bllokimit te tyre. Zenia eshte rreth 38%.

Skema 3

SHK-3 Njesia Administrative Ana e Malit

Situata e kanaleve te para kullues: Kjo situate e ketyre kanaleve nuk paraqitet e mire, kjo pasi zona te cilen keto kanale kryejn funksionin e tyre eshte nje zone potenciale permbytjeje e cila ndikon ne mbushjen e shpejte te ketyre kanaleve pra ne depozitimin ne mase te madhe te aluvioneve,gje e cila kerkon periudha me te shpeshta kohore pastrimi.

Situata e kanaleve te dyta kulluese: Gjendja e kulluese ketyre kanaleve eshte teper e renduar per arsyet qe u permenden me siper,nderhyrjet ne disa raste nuk jane bere prej me shume se 20 vitesh, vitin e kaluar bashkia Shkoder ka nderhyre ne disa kanale me nje gjatesi totale prej 2.4 km.problematike mbeten bankinat e kanaleve dhe me pak ndertimet e mbikalimeve kto te fundit ne mase me te kufizuar se ne njesite e tjera. Zenia eshte rreth 38%.

Situata e kanaleve te treta kulluese: Keto kanale nuk kane patur asnje lloj nderhyrjeje,jane shum pak funksional per shkak te mospastrimit te tyre nder vite. Zenia eshte rreth 39-40%.

Skema 4

SHK-4 Njesia Administrative Berdice dhe Dajc

Situata e kanaleve te para kulluese: Gjendja e kettyre kanaleve nuk eshte aspak e mire edhe pse jane pastruar para disa vitesh,por per arsye se duke qene kanale qe kullojne zona qe permbyten edhe mbushja e tyre me aluvione eshte me e shpejte,duhet nderhyrje ne periudha sa me te dhpeshta kohore.

Kanalet e dyta kulluese paraqiten ne te njejten gjendje,megjithe se vitin e fundit eshte nderhyre nga Bashkia ne pastrimin e disa segmenteve si ne Njesine Administrative Berdice ne nje gjatesi prej 3.7 km dhe Njesine Administrative Dajc ne nje gjatesi prej 4,7 km.Problematike e madhe mbeten bllokimi dhe zenia e bankinave te kanaleve,si dhe ndertimi pa kriter i mbikalimeve. Zenia eshte rreth 35%.

Kanalet e treta jane te papastruara ne masen 40%,per shkak te mos nderhyrjes ne vite.

Skema 5

SHK-5 Njesia Administrative Velipoje

Situata aktuale e kanaleve te para (kolektoreve): Situata e Kolektoreve paraqitet jo e mire pasi eshte bere nje nderhyrje vetem pjesore ,ne segmente te vecanta afet hidrovoreve

dhe jo ne gjithe gjatesine e tyre,gje e cila ben te kullohet vetem tokat prane tyre ndersa siperfaqja tjeter eshte totalisht e pa kulluar.

Kanalet e dyta te cilet jane specifike pasi jane ne permasa te medha jane totalisht te papastruara pervec nderhyrjes se bere nga Bashkia Shkoder ne nje gjatesi prej 4.5 km,per zonen e Casit duhet nje studim i skemes se kullimit pasiskema po del jashte funksionit si rezultat i uljes se nivelit tabanit te tokes,Nuk ka probleme me bankinat e kanaleve dhe shum pak ndertime mbikalimesh. Zenia eshte rreth 30%.

Kanalet e treta, ne keto kanale nuk eshte nderhyre per vite me rradhe, rezultojne me zenie rreth

40% ,te volumit te tyre.

8. TË DHËNA TEKNIKE DHE SPECIFIKIME TË SKEMAVE KULLUESE EKZISTUESE

8.1. Skema 1 (nuk eshte pjese e projektit te LA)

Emertimi SH K- 1

Pika shkarkimit Liqeni i Shkodres

Sistemi me rrjedhje te lire

Siperfaqja e kullimit 2500 Ha

Gjatesia totale e kanaleve kulluese eshte 98 km,te ndara ne 23 km kanale te dyta dhe ne 75 km kanale te treta,*vecori e kesaj skeme eshte se nuk ka kanal te pare kullues.*

Kjo skeme mbulon territorin e Njesise Administrative Rrethina dhe nje pjese te zones perendimore te Bashkise Shkoder (zona e livadheve)

Kjo zone eshte mjaft e veshtire per nderhyrje ne pjesen me te madhe te saj pasi vitet e fundit eshte kthyer ne nje zone urbane (zone me perparesi legalizimi), pastrimi i kanaleve te dyta ne pjesen me te madhe duhet te konsiderohet me transport.

Kanalet e treta ne shumicen e rasteve nuk kane asnje gjurme,por edhe aty ku ekzistojne nderhyrja eshte shume e veshtire per shkak te zenies se bankinave te tyre ,ndertimeve pa kriter,linjave elektrike si dhe vendosjes ne mase te madhe te tumbinave ne shumicen e rasteve pa asnje parameter.

8.2. Skema 2

Emertimi SH K – 2

Pika e shkarkimit Lumi Kir

Sistemi me rrjedhje te lire

Siperfaqja e kullimit 1394 Ha

Kjo skeme perfshin te gjithe territorin e Njesise Administrative Guri i Zi.

Gjatesia totale e kanaleve kulluese eshte 99.0 km, te ndara ne **13.6 km kanale te para**, **20.4 km kanale te dyta** dhe **65 km kanale te treta**, vecori e kesaj skeme eshte se ka vetem dy

kanale te pare kullues me drejtimin lindje perendim, te cilet bashkohen ne afersi te fshatit Kuc rreth 2.1 km para se te derdhen ne lumin Kir.

Koeficienti i kullimit qe i sherben siperfaqe ne hektar toke sipas kategorise se kanaleve per 1 ml eshte a.kanale te para KK I- 0.1 **Ha/ml, b. Kanale te dyta KKII- 0.07 Ha/ml, kanale te treta KKIII- 0.02 Ha/ml.**

8.3. Skema 3

Emertimi SH K – 3

Pika e shkarkimit Lumi Buna

Sistemi me rrjedhje te lire

Siperfaqja e kullimit 1450 Ha

Kjo skeme mbulon te gjithe territorin e Njesise Administrative Ana e Malit

Gjatesia totale e kanaleve kulluese eshte 84.7 km, te ndara, keto ne 10 km kanale kulluese te para, 14.7 km kanale te dyta kulluese dhe 60 km kanale te treta kulluese. Kanalet e para kulluese e pershkojne te gjithe fushen Oblike-Obot dhe Muriqan me drejtimin veri-jug dhe shkarkim ne lumin Buna.Vecori e kesaj skeme eshte numri i kufizuar i kanaleve te dyta kulluese dhe numri i madh i kanaleve te treta kulluese kjo per shkak edhe te konfiguracionit te terrenit.

Koeficienti i kullimit qe i sherben siperfaqes ne hektar toke sipas kategorise se kanaleve per 1 ml eshte a.kanale te para KK I- 0.13 **Ha/ml, b. Kanale te dyta KKII- 0.09 Ha/ml, kanale te treta KKIII-0.02 Ha/ml.**

8.4. Skema 4

Emertimi SHK – 4

Pika e shkarkimit Mertemze- Vilu – Det

Sistemi eshte me rrjedhje te lire

Siperfaqja e kullimit 4400 Ha

Kjo skeme mbulon territorin Njesive Administrative Berdice dhe Dajc, dhe nje pjese te teritorit te Njesise Administrative Bushat (Bashkia Vau i Dejes).

Gjatesia totale e kanaleve kulluese te kesaj skeme eshte 321 km, te ndara perkatesisht keto ne 34.2 km kanale te para nga te cilat 21 km shtrihen ne Njesine Administrative Dajc dhe 13.2 km ne Njesine Administrative Berdice, 46.8 km kanale te dyta te ndara keto ne 24 km ne Njesine Administrative Dajc dhe 22,8 km ne Njesine Administrative Berdice,si dhe 240 km kanale te treta te ndara dhe keto ne 120 km ne Njesine Administrative Dajc dhe 120 km ne Njesine Administrative Berdice. Vecori e kesaj skeme eshte se perbehet nga 3 kanale te pare me drejtimin veri-jug qe bashkohen ne keneten e Mertemzes dhe sibashku derdhen ne Lagunen e Vilunit dhe pastaj ne det.

Persa i perket Njesise Administrative Dajc koeficienti i kullimit qe i sherben siperfaqes ne hektar toke sipas kategorise se kanaleve per 1 ml eshte a.kanale te para KK I- 0.12 **Ha/ml, b. Kanale te dyta KKII- 0.1 Ha/ml, kanale te treta KKIII-0.02 Ha/ml.**

Persa i perket Njesise Administrative Berdice koeficienti i kullimit qe i sherben siperfaqes ne hektar toke sipas kategorise se kanaleve per 1 ml eshte a.kanale te para KK I- 0.15 **Ha/ml, b. Kanale te dyta KKII- 0.2 Ha/ml, kanale te treta KKIII-0.02 Ha/ml.**

8.5. Skema 5

Emertimi SHK – 5 (Hidrovoret 1,2)

Pikat e shkarkimit Laguna e Vilunit dhe Det

Sitemi eshte me ngritje dhe perbehet nga dy hidrovore Hidrovori 1 Cas,dhe Hidrovori 2 Velipoje,Vilun

Kjo skeme mbulon te gjithe territorin e Njesise Administrative Velipoje dhe nje pjese te Njesise Administrative Dajc,nje pjese te tokave te fshatit Pentar te shtrira ne fushen e Casit. Gjatesia totale e kanaleve kullues eshte 141.4 km, te ndara perkatesisht ne 26.8 km kanale te para. 24.6 km kanale te dyta kullues,si dhe 90 km kanale te treta kulluese te siperfaqes qe kullohet.

Veçori e e kesaj skeme eshte se kjo skeme eshte teresisht me ngritje mekanike e cila realizohet nga 2 hidrovore perkatesisht Hidrovori 1 Cas dhe Hidrovori 2 Vilun,perbehet nga 2 kanale kullues te pare ose te quajtur “kolektore” perkatesisht kolektori i Casit me drejtimin perendim – lindje dhe qe perfundon ne hidrovorin Cas,kolektori i Velipojes i cili ka drejtim perendim-lindje-jug me pike fundore hidrovorin Velipoje, Vilun.

Koeficienti i kullimit qe i sherben siperfaqes ne hektar toke sipas kategorise se kanaleve per 1 ml eshte :

a. **Kanale te para KK I- 0.11 Ha/ml,**

b. Kanale te dyta KKII- 0.2 Ha/ml,

c. Kanale te treta KKIII-0.02 Ha/ml.

Sipas analizes dhe llogaritjeve te bera nga Agronomet dhe inxhieret Hidroteknike te bashkis Shkoder ne lidhje me sasine e aluvioneve apo sasise se dherave qe kalojne nga fusha ne kanalet kulluese si rezultat i erozionit rezulton qe:

Sasia e dheut qe largohet nga 1m^2 toke ne kanal eshte nga 1 mm/m^2

Llogaritur nga kjo e dhene per 10.900 Ha del qe cdo vit sasi e dheut qe perfundon ne kanale e llogaritur ne intervalin mesatar te sasise materialit per m^2 eshte afersit 100.000 m^3/vit.

8.6. Veprat e artit në skemat kulluese SHK-2, 3, 4, 5

Situata e veprave te artit ne skemen Kulluese SHK-2, 3, 4, 5 paraqitet në tabelën përmbledhëse më poshtë:

Tabela No 10. Gjendja e veprave të artit

Skemat	Mbulimi	Ligjishmëria	KK I	KK II	KK III	Gjendja
Skema 2	Guri Zi	Të ligjshme	12	20	120	Funksionale
			3	7	34	Jo funksional[5]
		Të paligjshme	0	20	65	Jashte parametrave teknik
Skema 3	Ana Malit	Të ligjshme	16	15	130	Funksionale
			4	5	43	Jo funksional
		Të paligjshme	0	10	60	Jashte parametrave teknik
Skema 4	Dajç	Të ligjshme	13	14	200	Funksionale
			2	2	10	Jo funksional
		Të paligjshme	7	0	0	Jashte parametrave teknik
	Berdice	Të ligjshme	20	40	200	Funksionale
			4	10	74	Jo funksional
		Të paligjshme	0	60	80	Jashte parametrave teknik
Skema 5	Velipojë	Të ligjshme	11	30	240	Funksionale
			1	6	33	Jo funksional
		Të paligjshme	2	15	70	Jashte parametrave teknik
Totali		**Të ligjshme**	**53**	**121**	**900**	Funksionale
			14	**30**	**194**	Jo funksional
		Të paligjshme	**9**	**105**	**275**	Jashte parametrave teknik
		GJITHSEJ	**72**	**226**	**1175**	

[5] Jo funksionale jane mbikalimet/tumbinot te cilat jane pjeserisht te zena nga mbushjet me dhera.

9. SHTRIMI I PROBLEMEVE

Ne kete kapitull paraqiten ne menyre skematike dhe analitike situata dhe problematika ne kanalet kulluese te njesive vendore te Bashkis Shkoder

1. Problematika te kanaleve	• Bankina (rruget e kanaleve) te te zena te kanaleve kulluese • Kanale II te papastruara per me shume se 10 vjet • Kanale te III ne shumicen e tyre te papastruara prej me shume se 27 vitesh • Bimesi shume e rritur ne kanale, ne shume raste peme shume vjecare qe kane demtuar edhe strukturen e kanaleve. • Tumbino dhe ura te vendosura pa kriter dhe jashte parametrave • Ne shume raste sherbejne si vendgrumbullim mbeturinash,inertesh dhe ne disa raste si kanale ujrash te zeza. • Linja elektrike mbi ose ne afersi te kanaleve gje qe veshtireson nderhyrjen

2. Problematika teknike	• Nuk ka nje inventar te sakte te kanaleve sidomos te treta • Nuk ka harta treguese sidomos per kanalet e treta • Nuk ka nje rregullore per mbrojtjen e kanaleve • Nuk ka kanale te hipotekuara si prone • Rritja e kapaciteteve teknike dhe njerezore • Mungojne mjetet e mekanizuara dhe paisjet

3. <u>Synimi ne te ardhmen</u>	• Rritja dhe permiresimi i kullimit • Rritja dhe permiresimi i cilesise se tokes (boniteti) • Rritja e prodhimit dhe permiresimi i cilesise se produkteve bujqesore • Rritja e te ardhurave te fermereve dhe permiresimi i jeteses • Rritja e efikasitet dhe eficences se sherbimit • Rritja e kenaqesise se qytetareve te zones per sherbimin e kullimit

9.1. Masat e propozuara për zgjedhjene problemeve

Per zgjidhjen e problemeve te mesiperme propozohen ne menyre skematike masat si me poshte :

1.Zgjidhja e problematikave	• Lirimi i te gjitha bankinave (rrugeve te kanaleve) te zena • Kanale te II te pastuara jo me shum se 3 vjecare • Kanale te III te pastruara jo me shume se 4 vjecare • Pastrim nga bimesia e rritur si dhe riparim i struktures se demtuar. • Heqja dhe pastrimi i kanaleve nga tumbino dhe urat e vendosura pa kriter,lejimi i tyre vetem ku eshte e nevojshme dhe vetem brenda parametrave. • Kthimi i kanaleve kulluese ne funksionin fillestar per te cilin jane krijuar. • Menjanimi ose eleminimi i linjave te ndryshme elektike, interneti mbi hapsiren ajrore te kanaleve apo linjave te tjera tokesore te ujsjelles kanalizimeve.

2.Database teknik	• Nje inventar i menjehershem dhe i sakte i te gjithe infrastruktures kulluese, sidomos kanaleve te III. • Paralelisht krijimi i hartave te sakta te vendodhjeve dhe permasave te tyre ku te pasqyrohen edhe veprat e artit. • **Krijimi i nje rregulloreje per kontollin dhe mirembajtjen e tyre** • Certifikimi i te gjitha kanaleve ne ZVRPP. • Rritje dhe zhvillim i parkut te mjeteve,nepermjet shtimit te numrit dhe te shumellojshmerise se tyre (DSHBP) • Rritja numrit te stafit si dhe trajnimi i vazhdueshem i tyre (DSHBP) .

3.Nje veshtrim per prespektiven	• Te maksimalizohet siperfaqja e kulluar e tokes bujqesore vit pas viti. • Rritja e cilesise se tokes (Boniteti). • Rendimente te rritura te prodhimeve bujqesore dhe blegtorale,si dhe rritje e cilesise se prodhimit te tyre • Rritje e te ardhurave direkte te fermeret,ulje e kostostos se prodhimit permiresim i kushteve te jeteses.

10. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM DHE QËLLIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMIT

Në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që "Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pika1: Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj: "Për Administrimin e Kanaleve Kulluese dhe Ujitëse 9.3.2017".
Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr.1108,datë30.12.2015, "Transferimi, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit", ka kaluar në administrim te Bashkise Bordin e Kullimit i cili me Urdher te Kryetarit te Bashkise Shkoder Nr. 14 date 19/01/2016 ka krijuar Drejtorine e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore.

Për realizimin e këtij shërbimi përvec strukturës së brendshme të Bashkisë së Shkodrës, që ndjek politikat vendore, harton programin e ndërhyrjes, termat e referencës dhe standardet, funksionon edhe Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore me sektorin e Ujitjes dhe Kullimit e përbërë nga 13 punonjës, tenikë dhe punëtorë të cilët kanë detyrë të kryejnë dhe të ndjekin në territor zbatimin e punimeve që kryhen për pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese.

Fondet e parashikuara për funsionimin e strukturës dhe për pastrimin dhe rehabilimin e kanaleve kulluese rezultojnë si në tabelën më poshtë:
Me kalimin e funksionit të ujitjes dhe kullimit, sipas ligjishmërisë të paraqitur më sipër, duhet të ndërhyhet me pastrime dhe riparime sipas nevojës dhe rast pas rasti ne kanale ujitës dhe kullues në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës. Ndërhyrja për pastrimin e kanalevë kullues siguron mbajtjen në nivelet optimale të ujrave duke eliminuar si dëmtimin e bimeve të mbjellura nga fermerët ashtu edhe të strukturës së tokës në vetvete.
Ndërhyrja në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse, dhe veprave të artit që sigurojnë mirëfunksionimin e tyre, është edomosdoshme për të bërë të mundur realizimin e rendimenteve të parashikuara nga fermerët për kulturat e ndryshme bujqësore.

Sherbimi i mirembajtjes se Kanaleve kulluese ne Bashkinë Shkoder eshte funksion i vete Bashkise. Për kryerjen e këtij funksioni në Bashkinë Shkodër janë ngritur strukturat përkatëse, organigrama e së cilës jepet më poshtë:



Struktura e ngritur funsionon bazuar:

Në ligjin nr 139/2015, "Per vetëqeverisjen vendore", neni 64, pika j,

Në ligjin, nr. 10405, dt 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërbimeve"

Në ligjin, nr. 147/2015, dt. 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016",

Në VKM, nr. 165, dt. 02.03.2016, "Për grupimin e njësive te vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administartivë të njësive të vetëqeverisjes vendore"

Në VKB: nr.16 dt. 28.04.2016, "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionërëve të zgjedhur ose të emëruar të nëpunësve civile e të punonjësve të administrates të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë për vitin 2016"

Në VKB nr17, dt 28.04.2016 "Për buxhetin e Bashkisë Shkodër, për vitin 2016"

Në vendimin nr. 261, dt. 11.05.2016 "Miratimi i strukturës dhe listës emrore, të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër, për vitin 2016", të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

Në strukturën e ngritur janë 21 Punonjes gjithsej: 8 punonjes te kesaj strukture jane inspektore prane Drejtorise se Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP, ndersa Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore (Drejtori varesie) me sektorin e Ujitjes dhe Kullimit e përbërë nga 13 punonjës, teknikë dhe punëtorë të cilët kanë detyrë të kryejnë dhe të ndjekin në territor zbatimin e punimeve që kryhen për pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese. Po kshtu ne njesite administrative janë te alokuar inspektore (specialiste bujqësie) te cilët mbikqyrin proceset e punës dhe jo vetëm.

Për vitin 2016, për realizimin e aktiviteteve/projekteve ne sektorin e kullimit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit te AMTP ishte planifikuar buxheti me vlerë totale 16,606 mijë lekë, ndër të cilat 24 % paga dhe sigurime shoqërore, 76 % shpenzime operative.

Tabela më poshtë jep informacion të detajuar mbi shpërndarjen e fondeve, dhe realizimin sipas zërave.

Tabela No.11. Struktura e shpenzimeve te sherbimit te kullimit te bashkise Shkoder *000 Lek*

Vitet	TOTAL		Paga + Sigurime		Shpenzime Operative		Investime	
	Plan	Realizimi	Plan	Realizimi	Plan	Realizimi	Plan	Realizimi
2016	19,211	17,875	6,568	**5,760**	12,643	**12,115**	0	0
2017- Realizimi 6 M I-re	48,271	31,672	10,059	4,890	8,770	1,380	29,442	25,402

Me poshte ne forme grafike jepet struktura e shpenzimeve faktike per vitin 2016 per drejtorine e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural. Ne kete grafik ashtu si ne tabelen me siper shikohet se investimet ne kete sherbim kane munguar.

Grafiku 7 **Realizimi i buxhetit për vitin 2016 sipas zërave në %**



Burimi: Bashkia Shkoder

Për vitin 2017, situata faktike e gjashtë mujorit të parë të vitit paraqitet si më poshtë përkundrejt planit të miratuar buxhetor.

Tabela No.12 Struktura e shpenzimeve te buxhetiti sherbimit te kullimit *000 Lek*

Programe		TOTAL		Paga + Sigurime		Shpenzime Operative		Investime	
		Plan	Realizimi	Plan	Realizimi	Plan	Realizimi	Plan	Realizimi
2016		19,211	17,875	6,568	5,760	12,643	12,115	0	0
2017/realizimi 6 M I-re		48,271	31,672	10,059	4,890	8,770	1,380	29,442	25402
Buxhti afat mesem	**2018**	22,288	0	10,059		12,229			
	2019	22.288	0	10,059		12,229		11,000	
	2020	23.540	0	10,869		12,671			

Burimi: Bashkia Shkoder dhe llogaritjet e veta

Per vitin 2016, Bashkia Shkoder nuk ka pasur mjete pastrami dhe germimi ne kanale dhe sherbimi eshte kryer vetem me prokurime gje qe ka sjellur dhe rritjen e kostove per njesi ne kete vit.

Tabela No.13 Planifikimi për Bujqësinë,Zhvillimin Rural dhe Trajmin e AMTP. /mijë lekë

Bujqësia dhe zhvillimi rural	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
Plani 2017	10,095		-	-	4,040	**32,505**
Realizimi 6-mujori I 2017	4215	1,360			0	**5,575**

Grafiku **Planifikimi i shpenzimeve për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për vitin 2017**



Foto te ndryshme te situates se kanaleve kulluese ne njesite administrative ku shtrihet projekti.

Foto qe tregojne gjendjen e kanaleve

Sic shikohet, gjendja e kanaleve kulluese eshte shume e renduar gje qe u be prezente edhe ne kapitullin e shtrimit te problemeve.

11. VLERESIMI ME VEZHGUES TE KUALIFIKUAR

Pershkrimi i formatimi te vezhguesve te kualifikuar.

Nga nje grup qytetaresh të njesive administrative te Bashkis u organizua nje vleresim per gjendjen e kanaleve kulluese dhe veprave te lidhura me to. E vecanta e ketij gupi eshte se ato u trajnuan per te bere vleresimin. Ato quhen Vezhgues te Kualifikuar (VK ose ToR). Vezhguesit e kualifikuar kanalet kulluese sipas metodolgjise se vlersimit nga 1-5 (ku 1 eshte shume mire dhe 5 eshte shume keq).

Planifikimi i vezhguesve te kualifikuar sipas njesive administrative

---

I. NJESIA ADMINISTRATIVE GURI ZI

Vezhguesi 1: Mbulon fshatrat: Ganjolle - Juban
Vezhguesi 2: Mbulon fshatrat: Guri Zi - Vukatane
Vezhguesi 3: Mbulon fshatrat: Kuç - Rrenc.
Vezhguesi 4: Mbulon fshatrat: Rragam - Gajtan

II. NJESIA ADMINISTRATIVE ANA E MALIT

Vezhguesi 1: Mbulon fshatrat: Oblike e Madhe
Vezhguesi 2: Mbulon fshatrat: Obot - Velinaj
Vezhguesi 3: Mbulon fshatrat: Muriqan – Shtuf
Vezhguesi 4: Mbulon fshatrat: Oblike e Siperme – Dramosh – Vallas - Vidhgar - Bobot

III. NJESIA ADMINISTRATIVE DAJC BREGU BUNES

Vezhguesi 1: Mbulon fshatrat: Darragjat – Shirq
Vezhguesi 2: Mbulon fshatrat: Mushan – Suka Dajç
Vezhguesi 3: Mbulon fshatrat: Dajç - Belaj
Vezhguesi 4: Mbulon fshatrat: Samrisht - Rrushkull
Vezhguesi 5: Mbulon fshatrat: Pentar – Mali Gjymtit

IV. NJESIA ADMINISTRATIVE BERDICE

Vezhguesi 1: Mbulon fshatrat: Beltojë – Mali Hebe
Vezhguesi 2: Mbulon fshatrat: Berdicë e Sipërme – Berdicë e Madhe
Vezhguesi 3: Mbulon fshatrat: Berdicë e Poshtme - Konaj
Vezhguesi 4: Mbulon fshatrat: Trush

V. NJESIA ADMINISTRATIVE VELIPOJE

Vezhguesi 1: Mbulon fshatrat: Velipoje - Pulaj
Vezhguesi 2: Mbulon fshatrat: Baks i Ri - Rrjollë
Vezhguesi 3: Mbulon fshatrat: Reç i Ri - Gomsiqe
Vezhguesi 4: Mbulon fshatrat: Luarzë – Ças – Mali Kolaj

Rezultatet e vleresimit te ndare sipas Njesive administrative rezultojne si me poshte:

KANALET E PARA

	Vlersuar me ToR gjendja e K Para ne %				
Nr Gjithsej	Sh Mire	Mire	Mjaftueshem	Keq	Shume Keq
48	**0.0**	**4.2**	**64.6**	**31.3**	**0.0**





KANALET E DYTA

Nr Gjithsej	Vlersuar me ToR gjendja e K Dyta per funksionimin ne %				
	Sh Mire	Mire	Mjaftueshem	Keq	Shume Keq
94	2.1	10.6	45.7	31.9	9.6





KANALET E TRETA

Nr Gjithsej	Vlersuar me VK gjendja e K Treta per funksionimin ne %				
	Sh Mire	Mire	Mjaftueshem	Keq	Shume Keq
772	**1.0**	**1.4**	**23.4**	**50.5**	**23.7**





Tabela No. 14. shumatore e Inventareve dhe Vleresimeve me ToR

KANALE TE PARA								942,393.6	**m3 mbushje**	
Te dhena Baze			Vlersimet me TOR					mbushja e kanaleve		
